



FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION

Adresa: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 43. Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.

Tel: +381 (0) 38 244 473

e-mail: info@fshsk.org, gezim.hazrolli@fshsk.org

RREGULLORE E GARAVE

FEDERATA E SHENJETARISE SPORTIVE E KOSOVES

11.11.2022

Në bazë të Nenit 22, pika 1.8 të Statutit të Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës, Këshilli drejtues në mbledhjen e mbajtur më 11.11.2022 miratoi:

RREGULLORE E GARAVE

KAPITULLI I

DREJTIMI DHE ORGANIZIMI I GARAVE

Neni 1

Garat vendore të shenjëtarisë sportive organizohen dhe drejtohen nga Federata e Shenjëtarisë Sportive të Kosovës ose në bashkëpunim me Klubet Sportive, mbi bazën e kalendarit sportiv vendor vjetor të hartuar nga FSHSK.

Neni 2

Vendi, data, ora dhe menyra e zhvillimit të çdo aktiviteti përcaktohet në Kalendarin Sportiv, në përputhje me strukturën organizative të miratuar nga Këshilli Drejtues i FSHSK.

Neni 3

Kalendarin Sportiv vendor është i detyrueshëm të zbatohet nga të gjithë Klubet e shenjëtarisë. Ai mund të ndryshohet nga Këshilli Drejtues i FSHSK vetëm në raste të jashtëzakonshme të cilat nuk mund të parashikohen më parë.

Neni 4

Të gjitha Garat vendore zyrtare do të zhvillohen detyrueshëm në poligonin e Shenjëtarisë Sportive në pallatin e Rinis dhe Sporteve në Prishtinë, ose edhe në poligone të tjera sportive të licencuara nga MPB dhe FSHSK.

Neni 5

Klubet sportive të cilat janë përcaktuar në kalendarin vendor për të zhvilluar Garat e shenjëtarisë dhe për arsye më të mira nuk mund të zhvillojnë ato në kohën e përcaktuar, duhet të njoftojnë Federatën 20 ditë përpara zhvillimit të aktivitetit.

Neni 6

Programi i zhvillimit te gares per cdo aktivitet vendor hartohet nga FSHSK dhe u komunikohet klubeve jo me vone se 5 dite perpara fillimit te aktivitetit te planifikuar.

Neni 7

Ne rastet kur nje aktivitet vendor nuk mund te zhvillohet ne vendin ose daten e caktuar ne kalendarin sportiv, te drejten e ricaktimit te dates dhe vendit per zhvillimin e atij aktiviteti e ka Keshilli Drejtues i FSHSK-se, dhe mirren masa per njoftimin ne kohe te ketij ndryshimi.

Neni 8

Administrata e FSHSK-se, se bashku me personin zyrtare te poligonit bejne pergatitjen e poligonit te shenjetarise per gare si dhe te bazes se nevojshme materiale teknike per zhvillimin normal te aktivitetit.

Neni 9

Poligonet, krahas disponimit te paisjeve te nevojshme per zhvillimin normal te garave, duhet te kene dhe dhoma zhveshje, dhomen e punes per Gjyqtar.

Neni 10

Klubet dhe sportistet pjesmarres ne garat vendore, transportimin e armeve dhe municioneve nga nje vend ne tjetrin duhet ta bejne vetem me automjete ne dispozicion konform LIgJI Nr. 05/L - 022. Ndalohet transportimi i tyre me mjete urbane (autobus ose tren).

Neni 11

Armet standarde dhe municionet sportive gjate zhvillimit te garave vendore te shenjetarise mbahen vetem ne depon e perkohshme te armatimit te poligonit ku zhvillohet aktiviteti. Mbajtja e armeve dhe municionit jashte depove te armatimit, ne hotele etj, eshte e ndaluar dhe penalizohet sipas ligjit.

Neni 12

Ne fillim dhe ne perfundim te cdo aktiviteti do te zhvillohet ceremonia e hapjes dhe ajo e mbylljes ku dorezohen diplomat, medaljet apo shperblime tjera me vendim te K.D. Klubet jane

te detyruar te marrin pjese me te gjithë pjesmarresit e regjistruar ne formularin e garave. Klubi ose sportisti qe ka zene vend nderi ne aktivitetin vendor, pa arsye nuk merr pjese ne ceremonine e dorezimit te shperblimeve skualifikohet.

Neni 13

Per fituesit e garave vendore FSHSK jep vleresime morale e materiale :

Klubit fituesi i jepet kupe dhe shpallet klubi me i sukseseshem i gares. Garuesit qe renditen nga vendi i pare deri tek i treti per te gjitha disiplinat u jepen diploma, me vednim te vecant te K.D mund tu ndahen edhe shperblime te tjera.

KAPITULLI II

PJESMARRJA

Neni 1

Ne Garat vendore zyrtare te shenjetarise sportive marrin pjese Klubet e Shenejtarise Sportive te cilat jane te pranuar dhe regjistruara ne FSHSK dhe te cilat Klube kan perfunduar te gjitha obligimet ne lidhje me kootizim-licencimin e klubeve deri ne afatet e percaktuara sipas statutit te FSHSK-se. Te gjithë garuesit pjesmarres duhet te jene te regjistruar e licensuar nga FSHSK, ne te kunderten pjesmarrja lejohet vetem jashte konkurences.

Neni 2

Regjistrimi dhe licensimi i klubeve te shenjetarise Sportive, per pjesmarrje ne garat vendore dhe nderkombetare te shenjetarise sportive do te behet deri ne muajin mars te cdo viti kalendarik.

Neni 3

Administrata e FSHSK-se, obligohet te dergoj njoftimin ne lidhje me garen, kushtet se bashku me formularin e gares 5 dite para gares.

Neni 4

C'do klub sportiv ploteson formularin e gares dhe e dergon ne administratene FSHSK-se, permes postes elektronike ose kopjes fizike dy dite para gares. Formulari duhet te plotesohet sipas disiplinave, moshave dhe gjinive. Neqoftese ka pasaktesi ne plotesimin e formularit, garuesi i caktuar nuk do te lejohet te marre pjese ne ate gare ose vetem jashte konkurences.

Neni 5

Ne garat zyrtare vendore dhe nderkombetare marrin pjese vetem trajneret, garuesit dhe gjyqtaret qe kane qendrim te mire moral dhe qe njohin e zbatojne rregullat e siguris teknike te shenjtarise.

Neni 6

Traineret dhe garuesit te cilet kane masa disiplinore te marra nga klubi i tyre sportiv ose nga Komisioni Dicipinor i FSHSK-se, nuk do te lejohen te marrin pjese ne aktivitetin vendor e nderkombetare.

Neni 7

Federimi i sportisteve sipas kategorive te moshes behet konform Rregullores teknike te shenjtarise sportive.

- Sportist Pioner quhet garuesi i moshes deri 16 vjec.
- Sportist Junior quhet garuesi i moshes 16-21 vjec
- Sportist Senior quhet garuesi i moshes mbi 21 vjec

Neni 8

Llogaritja e moshes behet me ditin, muajin dhe vitin e lindjes karshi dates, muajit dhe vitit kur zhvillohet aktiviteti (nese nje garues i aktivizuar me Pioner, ne ditin e gares mbush moshen 17 vjec, nuk lejohet te marre pjese me Pioner).

Neni 9

Ne Garat vendore garuesi lejohet te marre pjese vetem ne nje lloj discipline (pushke ose pistolette). Nuk lejohet qe nje garues te marre pjese ne dy disiplina qofshin Serike apo Satandarde, Pushke dhe Pistolet.

KAPITULLI III

GJYQTARET, PJESMARRJA DHE AKTIVIZIMI

Neni 1

Ne Garat vendore te shenjetarise sportive gjykojne gjyqtare te cilet jane regjistruar e licensuar dhe kategorizuar nga FSHSK.

Neni 2

Regjistrimi dhe licensimi i gjyqtareve vendor per pjesmarrje ne Garat vendore te shenjetarise sportive do te behet deri ne mars te cdo viti, se bashku me licensimet e klubeve.

Neni 3

C'do klub sportiv regjistrohet duke plotesuar formularin e regjistrimit te aprovuar nga FSHSK.

Neni 4

C'do gjyqtar ne perberje te klubit ose individualisht pervec listes se federimit duhet te dergoje ne FSHSK dhe pagesen e licensimit si antar. Per cdo license do te paguhet vlera e percaktuar nga Asambleja e Pergjithshme e Federates. Gjyqtaret qe nuk bejne licensimin ne kohen e duhur nuk kane te drejte te marrin pjese ne garat vendore

Neni 5

Ne Garat zyrtare vendore (zyrtare ose miqsore) marrin pjese vetem gjyqtaret, qe kane qendrim te mire moral dhe qe njohin e zbatojne rregulloren e sigurimit teknik te shenjetarise.

Neni 6

Gjyqtaret te cilet kane masa disiplinore, nuk do te lejohen te marrin pjese ne aktivitetin vendor.

Neni 7

Caktimi i numrit te gjyqtareve dhe aktivizimi i tyre ne Garat vendore sipas kategorive te moshes (Pioner, Junior, Senior) behet konform Rregullores Teknike te Shenjetarise Sportive.

Neni 8

Caktimi i Kryegjyqtarit dhe gjyqtareve te tjere behet nga Sekretari I Pergjithshem I Federates ne bashkepunim me Keshillin e Gjyqtareve, mbeshtetur ne kete Rregullore, ne kategorite e tyre si dhe ne kompetencen e gjykimit ne Garat e zhvilluara ne cdo vit kalendarik, duke pasur parasysh ne aktivizimin e tyre si dhe rregullin e gjithperfshirjes dhe te barazise.

Neni 9

Gjyqtaret e licensuar prane FSHSK jane te detyruar te marrin pjese ne te gjitha seminaret dhe kurset e kualifikimit te organizuara nga kjo Federate, per ngritjen e tyre profesionale si dhe njohjen me rregullat e reja (vendore dhe nderkombetare).

Neni 10

Ne Garat vendore ne cdo veprim gjyqtari do te mbeshtetet rigorozisht ne Rregulloren Teknike vend te zhvillimit te garave te shenjetarise duke mbajtur pergjegjesi per zbatimin e saj.

Neni 11

Kur gjyqtaret shkelin rregulloren marrin masa disiplinore te percaktuara ne Kapitullin V –te te kesaj Rregullore, neni 4.

KAPITULLI IV

ORGANET KOMPETENTE PER DHENIEN E DENIMEVE

Neni 1.

Organet per marrjen dhe dhenien e vendimeve te masave disiplinore jane :

- Komisioni Disiplinor
- Komisioni i Ankesave

Neni 2

Organi me i larte gjyqsor i FSHSK eshte Komisioni i Ankesave . Komisioni i Arbitrazhit Sportiv (K.A.S) i cili funksion prane KOK-ut, pranon, shqyrton dhe jep vendimin perfundimtar ne rast ankesash per vendime te padrejta te marra nga Komisioni i Ankesave të FSHSK-së, ndaj antareve te saj. Vendimi I KAS – it eshte perfundimtar dhe i pa apelushem.

Neni 3

Komisioni Disiplinor mund te marre masa disiplinore per Klubet, sportistet si dhe per individe te veçante duke dhene ne varesi te shkeljeve, denimet sipas kodit disiplinor.

Neni 4

Komisioni Disiplinor i FSHSK eshte organi kompetent i gjykimit ne shkallen e pare dhe ka kompetencen te analizoje te gjykoje dhe te marre masat perkatese per shkeljet e bera nga antaret e saj. Ai mund te jape vendimet e meposhteme :

- Paralajmerime
- Pezullim dhe perjashtim deri nje vit nga Garat vendore dhe ndervendore te trainereve, gjyqtareve dhe sportisteve.
- Ulje ne kategori te gjyqtareve dhe trainereve
- Vleresimin dhe analizimin e protestave dhe reklamimeve qe jane paraqitur nga individet dhe Klubet gjate aktivitetit zyrtar dhe qe nuk ka marre pergjigje te drejte nga gjyqtaria.

KAPITULLI I V

LLOJET E DISIPLINAVE TE SHENJETARISE SPORTIVE SIPAS GRUPMOSHAVE, PUSHKE DHE PISTOLET AJRORE 10m

Neni 1. Pushke Serike Pioner 10m

1. 2 Ne Garat vendore te shenjetarise sportive **per Pioner me Pushke Serike** meshkuj e femra, numuri i pjesmarrsve per tu klasifikuar si kategori duhet te jene se paku 3 garues meshkuj ose femra :

- Pushke Serike ajerore 10m 4 x 5 - 3 e me shume femra
- Pushke Serike ajerore 10m. 4 x 5 - 3 e me shum meshkuj

Neni 1. 3 Pushke Serike Junior 10m

1. 4 Ne Garat vendore te shenjetarise sportive **per Junior me Pushke Serike** meshkuj e femra, numuri i pjesmarrsve per tu klasifikuar si kategori duhet te jene se paku 3 garues meshkuj ose femra :

- Pushke Serike ajerore 10m. 4 x 5 - 3 e me shume femra
- Pushke Serike ajerore 10m. 4 x 5 - 3 e me shume meshkuj

Neni 1. 5 Pushke Serike Senior 10m

1. 6 Ne Garat vendore te shenjetarise sportive **per Senior me Pushke Serike** meshkuj e femra, numuri i pjesmarrsve per tu klasifikuar si kategori duhet te jene se paku 3 garues meshkuj ose femra :

- Pushke Serike ajerore 10m. 4 x 5 - 3 e me shume femra
- Pushke Serike ajerore 10m. 4 x 5 - 3 e me shume meshkuj

Neni 1.7 Ne rast se nje grup moshe ka me pak se 3 garues ateher garuesit kalojne ne nje grup mosh me te madhe.

1.8 Pushke Standarde 10m, pozicioni ne kembe

1.9 Junior dhe Senior Pushke Standarde 10m, pozicioni ne kembe, Ne Garat vendore te shenjetarise sportive **per Junior dhe Senior me Pushke Standarde** meshkuj ose femra, numuri i pjesmarrsve per tu klasifikuar si kategori duhet te jene se paku 3 garues meshkuj ose femra, ndersa gara zhvillohet sipas standardeve te ISSF, llogaritja behet nga caqet elektronike me decimale.

- Pistolet ajer 10 x 6 - 3 e me shume femra
- Pistolet ajer 10x 6 - 3 e me shume meshkuj
- Pushke ajer 10x 6 - 3 e me shume femra
- Pushke ajer 10x 6 - 3 e me shume meshkuj

Prishtinë 11.11.2022

Kryetari i FSHSK-së

Gëzim Hazrolli


